

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 194 Prot.

Tiranë, më 10.02 2017

VENDIM Nr. 20, datë 09.02.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 2 të datës 09.02.2017, pasi shqyrtoi Relacionin e verifikimit në terren të disa strukturave muresh, të zbuluara gjatë zbatimit të *projektit "Sheshi publik para hyrjes së Portit të Durrësit", Bashkia Durrës*, realizuar nga Instituti i Arkeologjisë. DRKK Durrës dhe ASHA,

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin e verifikimit në terren të disa strukturave muresh, të zbuluara gjatë zbatimit të *projektit "Sheshi publik para hyrjes së Portit të Durrësit", Bashkia Durrës*, realizuar nga Instituti i Arkeologjisë, DRKK Durrës dhe ASHA.
2. Të vijojë nga Instituti i Arkeologjisë, gjurmimi arkeologjik me qëllim sqarimin e mëtejshëm të kohës së ndërtimit, karakterit dhe funksionit të strukturave ndërtimore të zbuluara.
3. Të kryhet nga Instituti i Arkeologjisë një sondazh arkeologjik, me qëllim sqarimin e objektivave të përcaktuara në pikën 2.
4. Gjetjet arkeologjike të depozitohen pranë fondeve të Muzeut Arkeologjik Durrës.
5. Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar) Investitori të mbulojë shpenzimet për kryerjen e proceseve arkeologjike sipas pikës 2 dhe 3.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUSIBARO-FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO